

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË

Zgjidhjet

P4



FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 20.10.2018

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA
A. Zgjidhje shumëfishe	20	
B. Zgjidhje opcionale	20	
1. Problemi 1	15	
2. Problemi 2	10	
3. Problemi 3	15	
4. Problemi 4	5	
5. Problemi 5	5	
6. Problemi 6	5	
7. Problemi 7	5	
Total	100	

1. Kompania BLU jep mallra për disa nga klientët e vet me marrëveshje shitje me mundësi kthimi. Si duhet të trajtohen mallrat e dhënë me këtë opcion?
 - a) Rregjistrohen si mallra në stoke tek BLU;
 - b) Nuk regjistrohen nga ana e klientit;
 - c) Regjistrohen si shitje nga ana e BLU;
 - d) Asnjëra më lartë;

2. Një tatimpagues që të konsiderohet person i tatueshëm për Tvsh, (përveq nëse regjistrohet vullnetarisht) duhet të arrijë përkatësisht të kalojë pragun e të ardhurave vjetore prej :
 - a) 30,000 Euro e më lartë për tu regjistruar në Tvsh;
 - b) Ndërmjet 30,000 euro deri 50,000 Euro për tu regjistruar në Tvsh;
 - c) 50,000 Euro e më lartë për tu regjistruar në Tvsh;
 - d) Asnjëra më lartë.

3. Për qëllime tatimore për njohjen e KMSH në fund të vitit cila metodë lejohet për trajtimin e stokeve?
 - a) Lejohet metoda LIFO;
 - b) Lejohet metoda FIFO;
 - c) Lejohet metoda HIFO;
 - d) Asnjëra më lartë.

4. Malsin Krasniqi në muajin Janar 2017 ka pranuar pagën e 13-të në formë bonusi për shkak të performancës në shitje gjatë vitit të kaluar; kjo pagë ka qenë e vetmja e ardhur gjatë vitit 2017 për Malsinin. Si duhet të trajtohet kjo pagë për deklarim në muajin Janar 2017?
 - a) Tatimohet njëjtë sikurse paga e dhjetorit 2016;
 - b) Si pagë sekondare;
 - c) Nuk tatimohet;
 - d) I bashkohet pagës bruto bazë të dhjetorit.

5. Sipas ligjit për Administratën tatimore dhe procedurat 03/L-222, shuma e ndonjë tatimi e paguar në përputhje me këtë ligj do të shpërndalet sipas rendit vijues:
- a) Interesi/ Sanksionet dhe pagesat ndëshkuese/ Shuma e çdo obligimi tatimor/ Shpenzimet e mbledhjes;
 - b) Shpenzimet e mbledhjes/ Shuma e çdo obligimi tatimor/ Sanksionet dhe pagesat ndëshkuese/ Interesi;
 - c) Shuma e çdo obligimi tatimor/ Sanksionet dhe pagesat ndëshkuese/ Interesi/ Shpenzimet e mbledhjes;
 - d) Shpenzimet e mbledhjes/ Interesi/ Sanksionet dhe pagesat ndëshkuese/ Shuma e çdo obligimi tatimor;
6. Kompania "JONI" shpk, kryen furnizime të tatueshme për të gjitha produktet që shet. Një klienti afarist i ka lëshuar faturën në vlerë prej 2,380.00 (pa e përfshirë Tvsh) dhe i ka ofruar një zbritje/lirim tregtare prej 8% mbi këtë shumë. Sa do të jetë vlera totale e faturës pas zbritjes duke përfshirë edhe Tvsh me normë të reduktuar prej 8% për furnizimin e bërë?
- a) 2,380.00 Euro;
 - b) 2,570.40 Euro;
 - c) 1,978.89 Euro;
 - d) 2,364.77 Euro.
7. Biznesi FLANDRA shpk veprimtaria afariste e të cilit është shërbime të dizajnit dhe arkitekturës, e cila për qëllime tatimore është biznes i regjistruar si Korporatë e Vogël me TVSH, si duhet të deklarojë tatimin e të hyrave nga aktiviteti i saj në baza tremujore ky biznes?
- a) Shërbyese me 10%;
 - b) Tregtare me 5%;
 - c) Shërbyese dhe tregtare me 3%;
 - d) Asnjëra më lartë.
8. Ne kuadrin e sistemit tatimor në Kosove janë të përfshira këto tatime dhe procedura:
- a) Procedurat e Administratës Tatimore;
 - b) TAK, TAK dhe TVSH;
 - c) Akciza dhe Tarifatat doganore;
 - d) Të gjitha më lartë.

9. Kompania "ART", në Tetor lëshon një notë kreditore për kompaninë "TRA" për shitjet të cilat i ka bërë para dy muajve tek kjo e fundit. Nota kreditore e lëshuar nga "ART" është në vlerë 900.40+Tvsh 18%. Për kompaninë "ART" kjo notë ka ndikim që:
- a) Zvoglon blerjet, rrit Tvsh e zbritshme;
 - b) Zvoglon blerjet, rrit Tvsh e llogaritur;
 - c) Zvoglon shitjet, rrit Tvsh e zbritshme;
 - d) Zvoglon shitjet, rrit Tvsh e llogaritur.
10. Cilat nga dokumentet burimore duhet të paraqitet në baza mujore në librat e blerjes dhe shitjes së një kompanie:
- a) Faturat blerëse dhe shitëse;
 - b) Notat kreditore dhe debitoare;
 - c) Kthimet e mallit të shitur dhe mallit të blerë;
 - d) Të gjitha më lartë;

1. Sipas ligjit nr. 06/L-016 për "Shoqëritë tregtare", çdo Shoqëri Tregtare duhet të ketë së paku dy Përfaqësues të Autorizuar.

E saktë

E pasaktë

2. Çdo person nga mosha njëzet (20) vjeçare, Shoqëri Tregtare ose grup i përbërë nga një ose më shumë persona nga mosha njëzet (20) vjeçare dhe/ose Shoqëri Tregtare mund të themelojë dhe regjistrojë një Shoqëri Tregtare.

E saktë

E pasaktë

3. Sipas ligjit nr. 06/L-032 për "Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", grupet e shoqërive tregtare për qëllime të këtij Ligji ndahen në ndërmarrje të vogla, ndërmarrje të mesme dhe ndërmarrje të mëdha, në varësi të treguesve të përcaktuar në baza konsoliduese të treguesve të përcaktuar në fund të vitit të kaluar financiar për qëllime të përgatitjes së pasqyrave financiare të vitit aktual.

E saktë

E pasaktë

4. Sipas ligjit nr. 06/L-032 për "Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", Shoqëritë tregtare me rastin e përgatitjes së pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme zbatojnë SNK-të dhe SNRF-të, SNRF-të për NVM dhe aktet nënligjore të nxjerra nga KKRF-ja.

E saktë

E pasaktë

5. Bazuar në ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, mospagesa e detyrimit tatimit në kohën e paraparë me ligjet tatimore, bazuar në Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat do të paguajë një interes prej 0.56% në muaj apo pjesë të muajit.

E saktë

E pasaktë

6. Sipas ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat çdo person jo-rezident i cili i nënshtrohet çfarëdo tatimi në Republikën e Kosovës në pajtim me legjislacionin tatimor të Republikës së Kosovës, do të caktojë një përfaqësues fiskal përpara se të fillojë ndonjë veprimtari ekonomike në Republikën e Kosovës. Përfaqësuesi fiskal do të regjistrohet në ATK brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pasi të jetë emëruar.

E saktë

E pasaktë

7. Bazuar në ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, kërkesa për kreditim ose rimbursimi për një pagesë të tepërt të çfarëdo lloji të tatimit mund të dorëzohet brenda gjashtë (6) vitesh nga data kur është paguar tatimi.

E saktë

E pasaktë

8. Sipas ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo shumë e tatimit e paguar mbi shumën e detyrimit tatimor (mbipagesë), me kërkesën e tatimpaguesit do të kreditohet ndaj detyrimit aktual të tatimpaguesit për detyrimin tatimore të llogarive të ndryshme tatimore.

E saktë

E pasaktë

9. Sipas ligjit nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shpenzimet e përfaqësimit do të jenë të kufizuara në dy përqind (2%) të të ardhurave bruto vjetore.

E saktë

E pasaktë

10. Sipas ligjit nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, a)Kompensimi ose pagat e paguara për personin e lidhur si dhe b)Interesi, qiraja dhe shpenzimet tjera që i paguhen personave të lidhur, lejohen si shpenzim i zbritshëm shuma që përcaktohet sipas vullnetit të tyre.

E saktë

E pasaktë

11. Sipas ligjit nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shpenzimet për përmirësimin e pronave me qira të cilat përdoren për aktivitete ekonomike të tatimpaguesit do të kompensohen përmes zbritjeve të zhvlerësimit të llogaritura me metodën lineare për periudhën e kohëzgjatjes së qirasë.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, secili person fizik afarist, ortakëri apo grupim i personave, që paguan qira, mban nëntë për qind (3%) të tatimit në të ardhurat bruto, në kohën e pagesës apo kreditimit.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, shpenzimet e trajnimit të paguara nga një punëdhënës për një të punësuar, që lidhen me punën, nuk lejohen plotësisht në vitin në të cilin shpenzimet e tilla të trajnimit kanë ndodhur.

E saktë

E pasaktë

14. Sipas ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, të ardhurat që i atribuohen një jo rezidenti në Kosovë si një zbatimës, sikurse është teatri, figurat e lëvizshme, artiste radioje apo televizioni, ose një këngëtar apo muzikant, ose si një sportist, nga aktivitetet e tij të ushtruara në Kosovë i nënshtrohet mbajtjes në burim nga paguesi i atyre të ardhurave, qoftë të paguara drejtpërdrejtë apo tërthorazi jo-rezidentit (përderisa personi apo entiteti jo-rezident nuk ka njësi të përhershme në Kosovë) shuma e mbajtjes në është 9% e kompensimit bruto.

E saktë

E pasaktë

15. Sipas ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, secili tatimpagues i cili realizon apo akruon të ardhura nga veprimtaritë afariste paguan tatimin çdo tre muaj në një llogari të caktuar nga ATK-ja në një bankë të licencuar nga BQK-ja jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të çdo tremujshi kalendarik.

E saktë

E pasaktë

16. Sipas ligjit të TVSh-së, tatimi i llogaritur kuptojmë - TVSh e obliguar apo e paguar në Kosovë në lidhje me mallrat apo shërbimet e furnizuara ose që do t'i furnizohen atij nga një person tjetër i tatueshëm; si dhe TVSh e obliguar apo e paguar në lidhje me importimin e mallrave në Kosovë;

E saktë

E pasaktë

17. Sipas ligjit të TVSh-së, çdo person që i përmbush të gjitha kushtet e përkufizimit mbi personin e tatueshëm, kërkohet që të regjistrohet për TVSH, nëse brenda vitit kalendarik tejkalon qarkullimin prej tridhjetëmijë euro (30.000€) dhe duhet të njoftojë ATK-në brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike prej momentit kur ka lindur obligimi për regjistrim.

E saktë

E pasaktë

18. Sipas ligjit të TVSh-së personi i tatueshëm mund të kërkojë rimbursimin e TVSh-së nëse për tre (3) muaj radhazi është në kreditim dhe në fund të muajit të tretë shuma e kreditimit të TVSh-së kalon vlerën prej njëmijë euro (1,000 €), si dhe nëse janë dorëzuar të gjitha deklaratat e TVSh-së dhe tatimeve tjera për të gjitha periudhat tatimore të kaluara.

E saktë

E pasaktë

19. Sipas ligjit të Punës, shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës themelojnë marrëdhënie pune sipas këtij ligji, nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas ligjit mbi Pensione në Kosovë, kontributet pensionale nga të punësuarit e huaj me qendrim të përkohshëm, në Kosovë, nuk janë të lejuara.

E saktë

E pasaktë

Pjesa C. Pyetjet problemore

Problemi 1

15 pikë

“RIANI” shpk me seli ne Prishtine regjistroj blerje gjatë Korrik/2018 në shumën 135,000 Euro me normën standarde; blerje në shumën 45,000 Euro me normën e reduktuar; shitjet vendore në këtë muaj ishin 250,000 Euro me normën standarde dhe 40,000 Euro me normën e reduktuar(Vlerat e paraqitura janë pa përfshirë TVSH-në).

Në muajin Korrik /2018 “RIANI” shpk ka pranuar një Note Krediti nga një furnitor për blerjet në muajin Shkurt 2018; Vlera e TVSH-se në këtë note krediti është 1,500 (me normë të reduktuar);

Poashtu pranoi një Note Debiti nga një furnitor për një blerje në muajin Dhjetor 2017. Vlera e TVSH-së në këtë note debiti është 400Euro (me normë standarde);

RIANI ka pranuar gjithashtu një faturë shërbimi nga kompania konsulente MERBACH me seli ne Gjermani ne vlere prej 5,000 Euro.

RIANI shpk po në këtë muaj (pra Korrik 2018) lëshojë një Note Krediti në të cilën vlera e TVSH-se është 900 Euro me normë të reduktuar).

Biznesi nuk ka pasur teprice kreditore te bartur nga muaji i kaluar.

Kërkohet:

A ka detyrim TVSH-së për të paguar në këtë muaj RIANI shpk, nëse po, sa është obligimi ? Plotëso deklaratën tatimore.

Zgjidhje:

[TV] FORMULARI I DEKLARIMIT TË TVSH

Periudha e Deklarimit:	Kolona [1]	07	2018
Numri Fiskal:	Kolona [3]	600700800	
Emri i biznesit:	Kolona [4]	RIANI SHPK	
Adresa e biznesit:	Kolona [5]	PRISHTINE, KOSOVË	
Emri i personit kontaktues dhe telefoni:	Kolona [6]	Fistek Filani 044/123123	

		Furnizimet Vlera	TVSH
Shitjet e tatueshme me normën 18%	Kolona [12]	250,000	45,000
Shitjet e tatueshme me normën 8%	Kolona [14]	40,000.00	3,200
Nota debitore e lëshuar, nota kreditore e pranuar me normë 8%	Kolona [18]	18,750.00	1,500
Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt	Kolona [28]	5,000	900
		Kolona [30]	50,600

		Blerjet Vlera	TVSH
Blerjet vendore me normë 8%	Kolona [43]	135,000	24,300.00
Blerjet vendore me normë 18%	Kolona [45]	45,000	3,600
Nota debitore e pranuar, nota kreditore e lëshuar me normë 18%	Kolona [53]	2,222.22	400
Nota debitore e pranuar, nota kreditore e lëshuar me normë 8%	Kolona [55]	11,250.00	900
E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	Kolona [65]	5,000	900
		Kolona [67]	30,100

		Kalkulimi Vlera	
Teprica a TVSH-së e bartur nga muaji i kaluar	Kolona [68]		
Balanca kreditore e mbetur 69 = ((67+68)-30)>0	Kolona [69]	-	
Kërkesa për rimbursim	Kolona [70]	-	
Kreditimi i tvsh-së per muajin pasues 71 =(69-70)	Kolona [71]	-	
TVSH që duhet të paguhet 72 =(30-67-68)>0	Kolona [72]	20,500	

Problemi 2

10 pikë

Gjatë muajit Qershor 2017 "TON" shpk regjistrojë blerje në shumën prej 30,000 Euro (për të gjitha blerjet është paguar TVSH me normën 18%); shitje vendore 45,000 Euro (me normë 18 % të TVSH-së); shitje të përjashtuara pa të drejtë kreditimi 22,000 Euro. (Vlerat e paraqitura NUK përfshijnë TVSH-në).

Sa për informacion "TON" shpk gjatë vitit 2016 regjistrojë blerje në shumën prej 320,000 Euro. Shitjet vendore ishin 750,000 Euro dhe eksportet ishin 110,000 Euro. Shitjet e përjashtuara pa të drejtë kreditimi për vitin 2016 ishin 365,000 Euro. (Vlerat e paraqitura NUK përfshijnë TVSH-në).

Kërkohe:

- Sa është koeficientit i TVSH-së së zbritshëm për vitin 2016?
- Sa ka detyrim të TVSH-së për te paguar në muajin Qershor 2017 për "TON" shpk?

Zgjidhje:

a)

$$KT = \frac{\text{Furnizimet e tatueshme} + \text{Eksportet}}{\text{Furnizimet e tatueshme} + \text{Eksportet} + \text{Furnizimet e përjashtuara}} \times 100 =$$
$$= \frac{750,000 + 110,000}{750,000 + 110,000 + 365,000} \times 100 = \sim 70\%$$

b)

LIBTI I SHITJEVE:

Shitjet e përjashtuara pa të drejtë kreditimi	22,000
Shitjet vendore	$45,000 \times 18\% = 8,100$
TOTAL TVSH e llogaritur	8,100

LIBRI I BLERJEVE:

Blerjet pa të drejtë kreditimi (II1)	10,620
Blerjet (30,000 x 70%) (II2)	$21,000 \times 18\% = 3,780$
TOTAL TVSH e zbritshëm	3,780

TVSH e pagueshme = TVSH e llogaritur - TVSH e zbritshëm

TVSH e pagueshme = 8,100 - 3,780 = 4,320 euro

(II1) $30,000 \times 30\% = 9,000 \times 18\% = 1,620$ TVSH që nuk pranohet e zbritshëm dhe pjesa tjetër- 9,000 (baza e kostos pa të drejtë kreditimi) + 1,620 = 10,620

(II2) $30,000 \times 70\% = 21,000 \times 18\% = 3,780$ TVSH e zbritshëm pasi që sipas ligjit të TVSH duhet përdoret koeficienti i vitit paraprak.

Problemi 3

15 pikë

Më poshtë jepet një përmbledhje e të ardhurave vjetore dhe shpenzimeve bruto të kompanisë BLENDI shpk 31. 12. 2017. Të ardhurat bruto janë 4,888,200 Euro, KMSH 2,598,000 Euro ndërsa shpenzimet e tjera operative janë 555,000 Euro

Informacion shtesë:

1. Shpenzime përfaqësimi 89,500 Euro (nga këto 4,000 Euro kanë të bëjnë me shpenzime pa faturë). (Kjo vlerë është përfshirë në shpenzime tjera).
2. Vlera e ndërtesave në fund të vitit ishte prej 350,000 Euro.
3. Asetet e kategorisë së dytë në fillim të vitit kishin vlerë 190,000 Euro. Një makine e e përdorur për gjurmimin e dheut u ble në shtator në vlerë prej 40,000 Euro.
4. Kompania dha donacion për fëmijët me aftësi të kufizuara në vlere prej 32,000 Euro të cilat janë të përfshira në shpenzimet tjera.
5. Llogarit e arketushme në fundë të vitit kanë një vlerë prej 550,000 Euro. Një provizion prej 22,000 Euro ishte caktuar gjatë vitit për ti mbuluar borxhet e dyshimta. Nga kjo shume 4,400 Euro kishin lidhje me shitjet e veçanta të regjistruara, të cilat mbeten të pa mbledhura edhe pas te gjitha hapave të mundshëm për arkëtim.
6. Janë paguar tre këste të tatimit në të ardhurat e korporatave sipas metodës historike ne vlere prej 12,000 Euro.
7. Shpenzimet operative të veturës në këtë vitë janë 16,000 Euro. Vetura është përdorë gjate vitit 70% për nevoja të biznesit, pjesa e tjetër e përdorimit ka të bëjë me përdorim privat të veturës.
8. Një transaksion me personat e lidhur ka ndodhe në funde të vitit dhe shitja është nënvlerësuar për 25,000 Euro.
9. Gjobat e trafikut në vlere prej 532 Euro, janë përfshirë në shpenzime tjera.
10. Shpenzimet e trajnimit në vlere prej 5,000 Euro kane te bëjnë me 5 punonjës të kompanisë, janë përfshirë në shpenzimet tjera.
11. Qiraja e muajit dhjetor në vlerë prej 2,000 Euro është paguar në Shkurt 2018. (Kjo vlerë është përfshirë në shpenzime tjera).

Zgjidhje:

Te ardhurat bruto	4,888,200
KMSH	(2,598,000)
Fitimi Bruto	2,290,200
Shpenzimet tjera	(555,000)
Fitimi para rregullimeve	1,735,200

Korigjimet nga informacionet:

1	Shpenzimet e përfaqesimit	40,618
2	Zhvlerësimi i ndërtesës	(17,500)
3	Zhvlerësimi i kategorisë së dytë	(42,000)
	Borxhi i keq	(4,400)
4	Shpenzimet e veturës	(11,200)
	Vleresimi i transaksioni/persona të lidhur	25,000
	Gjobat e trafikut	532
	Shpenzimet e trajnimit	(5,000)
	Donacioni	32,000
	Fitimi para donacionit	1,753,250
	Donacioni	(32,000)
	Fitimi para tatimit	1,721,250
	Tatimi@10%	(172,125)
	Fitimi neto	1,893,375

Sqarime:

1. $4,888,200 \times 1\%$ (norma e lejuar) = 48,882 euro shpenzime te lejuara; vlere prej 4,000 euro e shpenzimeve pa faturë do të pëfshihet në pjesën e shpenzimeve te papranuar. Pra, $89,500 - 48,882 = 40,618$ euro duhet korigjuar shpenzimet pasi jane shpenzime te papranuara.

2. $350,000 \times 5\% = 17,500$ shpenzim i zhvleresimit;

3. $190,000 \times 20\% = 38,000$; per asetet ekzistuese si dhe $40,000 \times 20\% / 2 = 4,000$ per Makinen e blere; pra ne total jane: $38,000 + 4,000 = 42,000$ euro

4. $16,000 \times 70\% = 11,200$ pranohen si shpenzime;

Problemi 4

5 pikë

Kompania ABC LLC për vitin 2017 ka pasur një fitim neto 385,150 Euro dhe tatim në të ardhurat e korporatave bazuar në deklaratën përfundimtare në vlerë prej 155,200 Euro.

Parapagimi i kësteve të barabarta ka qenë në shumë prej 37,000 EUR (metoda historike), diferenca prej 7,200 Euro është paguar me deklaratë përfundimtare me 31 mars 2017.

Bazuar në vendimin e menaxhmentit të kompanisë për vitin 2017 parapagimi i tatimit në të ardhurat e korporatave do të vazhdoje të paguhet bazuar në metodën e ë “**strehës së sigurt**” edhe pse është planifikuar sipas këtij buxheti se fitimi neto do të jetë rreth 580,000 Euro.

Kërkohet:

Sa do të jetë shuma e një kësti për vitin 2018 për Kompaninë “ABC LLC”.

Zgjidhje

Për periudhën vijuese të vitit 2018, paguhet së paku një e katërta (1/4) e 110% të detyrimit tatimor të përgjithshëm të periudhës paraprake (në këtë rast të vitit 2017), që ishte 155,200 Euro.

Kalkulimi për këstet e vitit 2018:

$$155,200 \times 110\% = 170,020 \times \frac{1}{4} = 42,680 \text{ Euro.}$$

Problemi 5

5 pikë

Lura Guri drejtuese në magazinën/depon e kompanisë "TONIMER" kishte punuar një kohë të gjatë në këtë kompani. Gjatë vitit 2017 ajo e ndërpreu punën për arsye të veta personale. Paga mujore e saj ishte në këtë vit 500 Euro. Me qenëse kishte një kohë të gjatë që Znj. Lura punonte në këtë kompani menaxhmenti i kompanisë vendosi një bonus në shenjë falenderimi në vlerë prej 1,500 euro me rrogën e fundit në Maj të 2017.

Kërkohet:

a) Llogaritni detyrimin pensional dhe detyrimin e tatimit që janë ndalur në burim nga kompania "TONIMER" për vitin 2017.

b) Llogaritni deklaratën përfundimtare në emër të Znj.Lura Guri dhe gjeni diferencën e tatimit në burim dhe detyrimin e tatimit për pagesë për vitin 2017.

Zgjidhje

a) Llogaritja e detyrimit pensional dhe detyrimit të tatimit në pagë:

Paga mujore: 500 euro

Pensioni $500 \times 5\% = 25 + 25 = 50 \times 5(\text{muaj}) = 250$

Tatimi $500 - 25 = 475$

$0 + 6.80 + 16.00 + ((475 - 450) \times 10\%) = 0 + 6.80 + 16.00 + 2.50 = 25.30 \times 5(\text{muaj}) = 126.50$

Bonusi: 1,500 euro

Pensioni $1,500 \times 5\% = 75 + 75 = 150$

Tatimi $1,500 - 75 = 1,425 \times 10\% = 142.50$

Përmbledhje: Detyrimi për KP = 250.00 + 150.00 = 400.00

Detyrimi për TAP = 126.50 + 142.50 = 269.00

b) Llogaritja e deklaratës përfundimtare vjetore:

Te ardhurat $(500 \times 5) + 1,500 = 4,000$

KP = $4,000 \times 5\% = 200 + 200 = 400$

TAP = $4,000 - 200 = 3,800$ (baza për tatim)

0 - 960 me 0% -> $0 \times 0\% = 0.00$

960 - 3000 me 4% -> $2040 \times 4\% = 81.60$

3000 - 3,800 me 8% -> $2400 \times 8\% = 64.00$

Obligimi për TAP 145.60

Diferenca: Tatimi në burim 269.00

Obligimi tatimorë 145.60

Rimbursim 123.40

Problemi 6

5 pikë

Kompania VESA INN më datë 31.12.2017 kishte këtë gjendje të aseteve sipas kontabilitetit (kosto historike) :

Grupi I - 356,500 Euro
Grupi II - 129,000 Euro
Grupi III - 378,000 Euro

Një aset prej 18,500€ që i takon grupit të dytë ishte blerë në Tetor 2017.
Të gjitha asetet janë blerë pas datës Janar 2014.

Kërkohet:

Të llogaritet zhvlerësimi sipas Ligjit Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave për secilën grup të aseteve fikse?

Zgjidhje:

Grupi I

$$356,500 \times 5\% = 17,825$$

Grupi II

$$\begin{aligned} 129,000 \times 20\% &= 25,800 \\ 18,500 \times 20\% / 2 &= \underline{1,850} \\ &27,650 \end{aligned}$$

Grupi III

$$378,000 \times 10\% = 37,800$$

Total: 83,250 euro

Problemi 7

5 pikë

Kompania HI-TEXT për vitin që përfundon me 31.12.2017 kishte këtë përbërje të fitimit para tatimit:

1. Fitimi nga aktiviteti afarist	230,000
2. Dividende	40,000
3. Te ardhura nga shitja e asetëve	<u>6,000</u>
Total	276,000

Sqarim: Te ardhurat nga shitja e asetëve ka të bëjë me shitjen e një kamjonete të blere në vitin 2009, dhe i takonte grupit të dytë të aseteve.

Kërkohe:

Llogarit tatimin në fitim të kompanisë HI-TEXT për te ardhurat e tatueshme sipas Ligjit Për Tatimin në te ardhurat e Korporatave për vitin 2017.

Zgjidhje

1. Fitimi nga aktiviteti	$230,000 \times 10\% = 23,000$ euro
2. Dividende	40,000 (a ardhur e përjashtuar)
3. Te ardhura nga shitja e asetëve	$6,000 \times 10\% = 600$ euro (fitim kapitali)
Obligimi tatimor	<u>23,600</u> euro